



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 19 mars 2021
Nr. ref.:RK 1730/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI239/19

Parashtrues

Hakif Veliu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hakif Veliu, të cilin e përfaqësojnë Durim Osmani dhe Feim Alaj, avokatë në K.A.M. PARTNERS, LLC, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 253/2019] e 30 shtatorit 2019, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR. Nr. 528/2018] e 16 prillit 2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 432/15], e 18 dhjetorit 2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore në Prishtinë).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka parashtruar kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i vendimeve] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës], nenin 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesat për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi, (kryesuese), Gresa Caka – Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 17 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) dosjen e rastit.
9. Më 27 janar 2020, Gjykata Themelore dorëzoi dosjen e plotë të rastit në Gjykatë.

10. Më 4 mars 2020, Gjykata e ktheu dosjen e plotë të rastit në Gjykatën Themelore.
11. Më 10 prill 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme që ta informojë Gjykatën si në vijim: (i) nëse parashtruesi i kërkesës ka qenë i njoftuar lidhur me shkresën [KMLP.II. nr.176/2019] të 27 gushtit 2019 të Prokurorit të Shtetit; (ii) që të dorëzojë kopjen e shkresës së lartcekur të Prokurorit të Shtetit; dhe (iii) duke ju referuar praktikës së Gjykatës Supreme, nëse në kuadër të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, a njoftohen palët përkitazi me shkresat e Prokurorit të Shtetit, përmes të cilës propozohet refuzimi i kërkesave të parashtruara nga pala për mbrojtje të ligjshmërisë, si e pabazuar.
12. Më 7 maj 2020, si rezultat i mospranimit të përgjigjes nga ana e Gjykatës Supreme dhe kalimit të afatit për dorëzim të informatës, Gjykata kësaj të fundit i dorëzoi një kërkesë për ripërsëritje të kërkesës për informatë.
13. Më 8 maj 2020, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë kopjen e “Përgjigje[s] në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë”, [KMLP.II. nr.176/2019], të 27 gushtit 2019 të Prokurorit të Shtetit dhe përgjigjen ndaj pyetjeve të parashtruara nga Gjykata.
14. Më 10 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 31 korrik 2015, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: PSRK) ngriti aktakuzën [PPS. nr. 145/2014] kundër parashtruesit të kërkesës për arsye se në bashkëkryerje kishte kryer veprën penale *”mashtrimi në detyrë”* nga neni 341, paragrafi 3 në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kodi i Përkohshëm Penal).
16. Parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e zyrtarit të Prokurimit në Universitetin e Prishtinës, ishte akuzuar se në bashkëkryerje me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kompaninë e përkthimit të librave (kompania ISN), me të cilin Universiteti kishte lidhur kontratë, kishin “falsifikuar kontratën origjinale” dhe në vijim ishte ndryshuar kontrata, e cila i kishte mundësuar kompanisë përfitim më të madh financiar për sasinë e njëjtë të shërbimit.
17. Me të njëjtën Aktakuzë, si dhe për bashkëkryerje për të njëjtën veprë të lartcekur penale, ishin akuzuar edhe dy persona të tjerë, njëri prej të cilëve ishte edhe A.R. [parashtrues i kërkesës në rastin KI230/19].
18. Më 18 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) me Aktgjykimin [PKR. nr. 432/15] parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për arsye se në bashkëkryerje kishte kryer veprën penale *”mashtrimi në detyrë”* dhe e dënoi atë me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, duke zëvendësuar dënimin me burgim me dënim me gjobë. Në vijim, Gjykata Themelore po ashtu obligoi të pandehurit, përfshirë edhe parashtruesin e kërkesës që Universitetit të Prishtinës t’ia kompensojë dëmin në mënyrë solidare në shumë prej 70.131, 27 euro.

19. Sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës në seancën dëgjimore në mbrojtjen e tij kishte theksuar "[...] se punën në Universitetin e Prishtinës e ka filluar në gusht të vitit 2008, në pozitën e Menaxherit të Zyrës së Prokurimit. Lidhur me aktivitetin e prokurimit "Përktimi i Librave Nga Gjuha Angleze në Gjuhën Shqipe Për Nevojat e Universitetit të Prishtinës", i pandehuri ka deklaruar se janë respektuar të gjitha procedurat e prokurimit, meqenëse OSHP me vendimin e saj kishte aprovuar kërkesën e UP-së, që lidhur me këtë aktivitet të prokurimit të vazhdohet me një operator të vetëm, pasi operatorët e tjerë nuk kishin qene të përgjegjshëm. Sipas [parashtruesit të kërkesës] kontrata e vlefshme ka qenë Kontrata sipas tenderit, e cila është dorëzuar në Ministrinë e Financave, e që e njëjta lidhet me pagesën dhe vetëm ajo është origjinale. Kontrata e dyte është lloj reference për qëllimet e operatorit ekonomik dhe nuk mund të përdoret lidhur me aktivitetin e prokurimit. I pandehuri me tutje ka shpjeguar se operatori ekonomik ISN me rastin e ndërrimit nga termi "fjalë" në "karakterë" është thirrur në atë se ky është një standard ndërkombëtar i përktimit, ndërsa shton se ai vet ka qene konfuz sa i përket njësisë matëse. Lidhur me pagesën e faturës së parë i pandehuri Hakif Veliu, ka deklaruar, se pas nxjerrjes së Urdhrit për Blerje nga Prokurimi, lënda duhet të kalojë edhe katër filtra e që janë: Zyrtari Pranues, Shpenzues, dhe ai Certifikues. Fatura në fjale sipas të pandehurit përmban njësinë matëse "F" që është nënkuptuar "fjalë", ndërsa se si është kalkuluar ajo ka qene obligim i Komisionit të Pranimit. Sa i përket pagesës së kontingjentit të dyte të librave ka deklaruar se, kur i ka arritur fatura atij i është dukur shumë e lart, dhe është ai i cili ka dyshuar dhe e ka dërguar këtë çështje në rektorat, që të formohet një komision për konstatimin e gjendjes reale të përktimeve".
20. Gjykata Themelore ndaj argumenteve të ngritura në mbrojtjen e parashtruesit të kërkesës ishte përgjigjur si në vijim: "Gjykata nuk e akcepton teorinë e mbrojtjes së të pandehurit Hakif Veliu të paraqitur nga vetë ai, por edhe nga mbrojtësi i tij av. Skender Musa, për faktin se Hakif Veliu duke vepruar si Shef i Zyrës së Prokurimit të UP-së, ka qene personi përgjegjës për nënshkrimin e kontratave, dhe njohës i procedurave të prokurimit publik. Për Gjykatën është e pa logjikshme se pas nënshkrimit të Kontratës sipas njësisë matëse "Fjala" e cila ishte edhe kusht në dosjen e tenderit, i pandehuri në cilësinë e sipër cekur, ka nënshkruar një Kontrate të dyte, pa i ndryshuar as datën e as numrin, por vetëm njësinë matëse. Është fakt gati notor që ndryshimi i njëjesisë matëse ka implikime edhe në buxhet, e duke u bazuar në detyrat e punës së tij, për Gjykatën është e pabesueshme se i njëjti këtë e ka bërë nga padituria. Deklarimet e Hakif Velikut në procedurë paraprake dhe në shqyrtim gjyqësor nuk kanë qenë në harmoni njëra me tjetrën. Deri sa në procedurë paraprake është mbrojtur se nënshkrimi në Kontratën sipas njësisë matëse "karakter", nuk është i tij, por kjo është falsifikuar, pas Ekspertizës Grafologjike të Agjencionit Kosovar të Forenzikes, Sektori për Ekspertimin e dokumenteve dhe dorëshkrimeve 2015-22.1112015-1983 ed. 08.07.2015, ka deklaruar se të njëjtën e ka nënshkruar, por e ka nënshkruar si lloj reference për ISN. Gjykata është e vetëdijshme që I pandehuri ka të drejtë të mbrohet në mënyrën që atë e favorizon, mirëpo kjo mospërputhje në deklarim, nënshkrimi i Kontratës sipas njësisë matëse "Karakter" dhe pastaj të gjitha veprimet e tij lidhur me përgatitjen e dokumenteve për Komisionin, shpërfaqin atë që quhet Mens Rea

(mendja kriminale) për të kryer vepër penale ne bashkëkryerje me te pandehurit e tjerë, në mënyrën siç u elaborua më lartë”.

21. Më 19 dhjetor 2017, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
22. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij pretendoi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, si dhe paraqiti ankesë për shkak të vendimit për dënim.
23. Së, pari, në lidhje me pretendimin për shkelje të dispozitave të procedurës penale, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të nenit 384 (Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale), paragrafit 1, nënparagrafit 1.7, 1.8 dhe 1.12 të Kodit Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm: KPPK) duke specifikuar se dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin, se aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme dhe se Gjykata Themelore nuk i paraqet në mënyrë të qartë faktet dhe arsyet se pse i konsideron të vërtetuara provat në lidhje me shpalljen e tij fajtor.
24. Së dyti, në lidhje me pretendimin për shkelje të ligjit penal, parashtruesi i kërkesës ndër të tjera pretendoi se ai nuk ka qenë personi zyrtar përgjegjës i vetëm për realizimin e kontratës për arsye se në mënyrë që të realizohet pagesa është dashur që të realizohen edhe veprime të tjera nga zyrtarët e tjerë, respektivisht nga zyrtari i pranimit, zyrtari shpenzues, zyrtari kryesor i autorizuar dhe zyrtari certifikues. Sipas parashtruesit të kërkesës, në hierarkinë e sistemit të ekzekutimit të pagesës zyrtari i prokurimit është i dyti.
25. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij po ashtu pretendoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, respektivisht shkeljen e të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, të parimit të provës më cilësore, dhe parimit të barazisë së armëve, që ndërlidhet me shpërfilljen e super ekspertizës, të cilën pretendon se e ka kërkuar para Gjykatës Themelore.
26. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte plotësuar ankesën e tij të parashtruar në Gjykatë të Apelit edhe përkitazi me vendimin për kërkesën pasurore juridike përkitazi me Universitetin e Prishtinës.
27. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore përkitazi me vendimin për dënim kishte parashtruar ankesë edhe PSRK, përkatësisht që ndaj parashtruesit të kërkesës të shqiptohet dënim më i lartë.
28. Më 2 maj 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [PAKR nr. 27/2018] e aprovoi ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në pjesën përkitazi me kërkesën pasurore juridike të kërkesës, duke e udhëzuar Universitetin e Prishtinës, në cilësi të të dëmtuarës në kontest civil, ndërsa pjesën tjetër të ankesës e refuzoi si të pabazuar. Gjykata e Apelit po ashtu kishte aprovuar ankesën e PSRK-së përkitazi me vendimin për dënim, duke e dënuar parashtruesin e kërkesës me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

29. Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të saj në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale se aktgjykimi mbështetet në provë të papranueshme, vlerësoi si në vijim: *“Me dispozita ligjore – nenin 257 të KPP është përcaktuar se kur një provë konsiderohet e papranueshme, kurse siç del nga shkresat e lëndës provat e administruara në shqyrtim gjyqësor në këtë çështje janë marrë konform dispozitave ligjore, ndërsa, sa këto prova janë thellësisht të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështjeje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga Gjykata”.*
30. Së dyti, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerësoi se me ndryshimin e kontratës nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe të akuzuarit A.R., si në vijim:
- “Me këto veprime të akuzuarit sipas vlerësimit të kësaj Gjykate i kanë konsumuar të gjitha elemente objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën janë akuzuar dhe shpallur fajtor. Pra, duke pasur parasysh rrethanat e lartcekura dhe arsyet e dhënë më gjerësisht në aktgjykimin e kundërshtuar kjo Gjykate vlerëson se përkitazi me këta të akuzuar gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë dhe se drejtë janë aplikuar edhe dispozita e ligjit penal.”*
31. Së treti, sa i përket pretendimit përkitazi me kërkesën pasurore juridike, Gjykata e Apelit e konsideroi këtë pretendim si të bazuar duke vlerësuar se Universiteti i Prishtinës, në cilësinë e palës së dëmtuar nuk ka parashtruar një kërkesë të tillë, dhe si rrjedhojë e udhëzoi këtë të fundit në kontest civil për realizimin e kësaj kërkesë.
32. Në fund, në lidhje me ankesën e PSRK-së për lartësinë e dënimit, Gjykata e Apelit e pranoi aplikimin e rrethanave lehtësuese nga Gjykata Themelore në rastin e parashtruesit të kërkesës, megjithatë sipas saj *“[...] ato nuk janë të asaj natyre që justifikojnë, ose janë të mjaftuara që të bëhet zbutja e dënimit nën kufirin e parashikuar me ligj [...]”*. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit aprovoi si të bazuar kërkesën e PSRK-së duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës dënimin prej një (1) vit burgim me arsyetimin se *“[...] këto dënime janë adekuate me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të [parashtruesit të kërkesës], dhe se me to mund të ndikohet në parandalimin e tyre nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tyre, por edhe në parandalimin e tjerëve nga kryerja e veprave penale, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitën e nenit 41 të [KPK-së]”*. Ndërsa sa i përket ankesës për vendimin për dënim, Gjykata e Apelit konstatoi se parashtruesi nuk e ka arsyetuar ankesën e tij përkitazi me vendimin për dënim dhe gjen se parashtruesit të kërkesës nuk mund t'i shqiptohet dënim më i butë.
33. Më 21 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 432/15], të 18 dhjetorit 2017 të Gjykatës Themelore, dhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 27/2018], të 2 majit 2018 të Gjykatës së Apelit, parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

34. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të KPPK, dhe shkelje esenciale të ligjit penal nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të KPPK.
35. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendoi se Gjykata e Apelit kishte shkelur nenin 390, paragrafin 1 të KPPK-së, për arsye se kjo Gjykatë kishte rritur dënimin e tij nga dënimi me gjobë në dënim me burgim për një (1) vjet.
36. Në vijim, parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike pretendoi se nuk ka qenë i ftuar në seancën e Kolegjit të Apelit. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht rastit KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 29 majit 2017.
37. Kundër Aktgjykimeve të lartcekura të Gjykatës Themelore, dhe asaj të Gjykatës së Apelit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kishte parashtruar edhe PSRK.
38. Më 15 tetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. Nr. 238/2018] e aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, duke e anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe çështjen e ktheu te e njëjta Gjykatë për rivendosje. Ndërsa kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga PSRK e refuzoi si të pabazuar.
39. Gjykata Supreme, duke ju referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (rastit të lartcekur KI104/16) konstatoi se:

“[...] se në rastin konkret me aktgjykimin e shkallës së dytë është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të KEDNJ. Kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret me të vërtetë të dënuarve në fjale iu është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë e garantuar me Kushtetute dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, meqë te njëjtit siç pretendohet në kërkesat e mbrojtësve të tyre, nuk janë njoftuar për seancën e shkallës së dytë me qellim që të paraqesin aspektet dhe argumentet e tyre lidhur me këtë çështje penale.”

40. Gjykata Supreme përfundoi se: *“Në rivendosje gjykata e shkallës së dytë duhet të evitojë shkeljet e konstatuara më lartë ashtu që për seancën e radhës të njoftojë të dënuarit dhe mbrojtësit e tyre e më pas të marrë një vendim të ligjshëm”.*

Procedura penale pas kthimit të rastit në rivendosje

41. Më 19 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur parashtresë për plotësimin e ankesës kundër Aktgjykimit [PKR. Nr. 432/2015], të 18 tetorit 2017, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe të ligjit penal.
42. Në lidhje me pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, parashtruesi i kërkesës pohoi se *“gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë*

asnjë arsye për faktet vendimtare përkatësisht se si [parashtruesi i kërkesës] e ka vënë në lajthim personin zyrtar”.

43. *Ndërsa në lidhje me pretendimin për shkelje të ligjit penal nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Kodit të Përkohshëm Penal, parashtruesi i kërkesës nënvizon se në “rastin konkret cilësimi juridik është i gabuar, në veprimet e [parashtruesit të kërkesës] kemi të bëjmë me rastin eklatant të falsifikimit të dokumentit zyrtar të parashikuar me nenin 348 të Kodit të Përkohshëm Penal, por asnjë element të veprës penale për të cilën ai është shpallë fajtor”.*
44. *Në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës së Apelit që “ta aprovojë ankesën e [tij] dhe Aktgjykimin e Shkallës së parë të anuloj dhe çështjen t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose ta refuzoj akuzën ose ta liroj [parashtruesin e kërkesës] nga akuza”.*
45. *Më 24 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit parashtrroi kërkesë për plotësimin e ankesës në lidhje me vendimin për sanksionin penal. Në parashtruesin e tij parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore gjatë “shqiptimit të llojit të sanksionit penal dhe lartësisë së saj nuk ka marrë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit nuk është shqiptuar dënimi i përshtatshëm për të mbrojturin tonë, respektivisht dënimi i shqiptuar nuk do të luaj rol në risocializimit përkundrazi do të ketë ndikim të keq ndaj të pandehurit dhe familjes së tij”.*
46. *Në mënyrë specifike parashtruesi pretendon se Gjykata Themelore gjatë matjes së dënimit nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si në vijim: (i) rrethanat personale dhe karakteri i parashtruesit, neni 74 (Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve), paragrafi 3, nënparagrafi 3.3. i Kodit Penal të Kosovës Nr. 04/L-082 (në tekstin në vijim: Kodi Penal); (ii) Bashkëpunimi i parashtruesit të kërkesës me gjykatën, prokurorinë dhe dorëzimi vullnetar, neni 74, paragrafi 3, nënparagrafi 3.8 i Kodit Penal; (iii) sjellja e parashtruesit të kërkesës pas ditës kritike të aksidentit, neni 74, paragrafi 3, nënparagrafi 3.12 i Kodit Penal. Dhe në fund, parashtruesi i kërkesës specifikon se “gjykata mund të zbusë dënimin ndaj [parashtruesit të kërkesës] edhe nën minimumin e paraparë me ligj, përkitazi për veprën penale që akuzohet [parashtruesi i kërkesës] për të cilin parashihet dënimi minimal prej 1 viti, zbutja e dënimit në kuptim të nenit 75 mund të vijë në shprehje nga gjykata për shkak të rrethanave lehtësuese ([...] në kuptim të nenit 73, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i Kodit Penal)”.*
47. *Më 16 prill 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. Nr. 528/2018] aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës në pjesën përkitazi me kërkesën pasurore, duke e udhëzuar Universitetin e Prishtinës, në cilësi të të dëmtuarës në kontest civil, ndërsa pjesën tjetër të ankesës e kishte refuzuar si të pabazuar. Gjykata e Apelit po ashtu kishte aprovuar ankesën e PSRK-së përkitazi me vendimin për dënim, duke e dënuar parashtruesin e kërkesës me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.*
48. *Gjykata e Apelit, në Aktgjykimin e saj në lidhje me pretendimin për shkelje të dispozitave të procedurës penale vlerësoi se pretendimet e parashtruesit të*

kërkesës nuk janë ta bazuara, duke vlerësuar se aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

49. Gjykata e Apelit, në mënyrë specifike duke iu referuar pretendimit të parashtruesit të kërkesës se aktgjykimi i kundërshtuar mbështetet në prova të papranueshme, vlerësoi se *“[...] provat e administruara në shqyrtim gjyqësor në këtë çështje janë marrë konform dispozitave ligjore, ndërsa, këto prova janë thellësisht të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimit të dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga Gjykata”*.

50. Ndërsa sa i përket pretendimeve për shkelje të ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vërtetoi se:

“[...] duke pasur parasysh provat e administruara por edhe mbrojtjet e të akuzuarve të cilat në mënyrë të detajuar janë theksuar në këtë aktgjykim sipas vlerësimit të kësaj Gjykate rezulton nëpërmjet ndryshimit të kontratës bazë kanë vënë në lajthim personat e autorizuar për kryerjen e pagesës së kundërligjshme. [...] Prandaj kjo Gjykatë i konsideron krejtësisht jo logjike dhe të pabazuara pretendimet se ndryshimi i kontratës është bërë vetëm si referencë për ISN dhe nuk kanë prodhuara efekt juridik, aq më tepër kur kihet parasysh fakti se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se bazuar në kushtet e tenderit palët kontraktuese e kanë pasur të ndaluar ta bëjnë një gjë të tillë sepse në mënyrë decisive ishte parashikuara (neni IV pika 3 e dosjes së tenderit) se çmimet në kontratë ishin të fiksuara dhe nuk mund të ndryshoheshin.”

51. Gjykata e Apelit, duke u bazuar në vlerësimin e saj si më lart konstatoi se me veprimet e lartpërmendura, parashtruesi i kërkesës i ka konsumuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, dhe si rrjedhojë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se drejtë janë aplikuar edhe dispozitat e ligjit penal.

52. Në vijim, në lidhje me ankesën e PSRK-së për lartësinë e dënimit, Gjykata e Apelit e pranoi aplikimin e rrethanave lehtësuese nga Gjykata Themelore në rastin e parashtruesit të kërkesës, megjithatë sipas saj *“[...] ato nuk janë të asaj natyre që justifikojnë, ose janë të mjaftuara që të bëhet zbutja e dënimit nën kufirin e parashikuar me ligj, sidomos kur kihet parasysh pesha e veprës penale [...]”*.

53. Në fund, sa i përket pretendimit përkitazi me kërkesën pasurore juridike, Gjykata e Apelit e konsideroi këtë pretendim si të bazuar duke vlerësuar se Universiteti i Prishtinës, në cilësinë e palës së dëmtuar nuk ka parashtruar një kërkesë pasurore juridike dhe si rrjedhojë e udhëzoi këtë të fundit në kontest civil për realizimin e kësaj kërkesë.

54. Më 9 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 432/15], të 18 dhjetorit 2017 të Gjykatës Themelore, dhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 528/2018], të 16 prillit 2019 të Gjykatës së Apelit.

55. Parashtruesi i kërkesë në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë pretendoi: (i) shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nënpragrafi 1.12 i KPPK-së; dhe (ii) shkelje të ligjit penal.

(i) *Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nënpragrafi 1.12 i KPPK-së*

56. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se: “[...] kjo gjykatë nuk ka dhënë asnjë arsye për faktet vendimtare me hollësisht se si [parashtruesi i kërkesës] e ka vënë në lajthim personin zyrtar. Gjykata e shkallës së parë e ka përshkruar ngjarjen në përgjithësi si një veprimtari që ka sjellë deri te pagesa që ishin në kundërshtim me kontratën fillestare, por nuk ka dhënë sqarime të detajuara se kush e ka vënë në lajthim shërbimin e pagesave që të bëj pagesa të tilla që nuk përkon me përmbajtjen e kontratës së pa ndryshuar (falsifikuar). Nga zhvillimi i ngjarjes del jo kontestues se në mënyrë të paligjshme është ndryshuar një nga pikat e kontratës, ashtu që njësia matëse “fjalë” është ndryshuar në njësinë matëse “karakter”, gjithashtu nuk është kontestuese se pagesa rezulton më e madhe kur përkthimi paguhet me njësi matëse “karakter” se me njësi matëse “fjalë”, siç përmbante marrëveshja fillestare.”

57. Në vijim, parashtruesi i kërkesës, po ashtu pretendoi se është vënë “[...] në lajthim nga i dënuari tjetër A.R., i cili e ka lutur që ta ndryshoj kontratën vetëm për pikën që ka të bëjë me njësinë matëse nga “fjalë” në “karakter” duke u arsyetuar se po i vyen për qëllime personale, mirëpo me këtë nuk është ndryshuar pika e kontratës që ka të bëjë me shumën e pagesës dhe mënyrën e pagesës e cila nuk ka ndryshuar, kurse i dënuari Hakif Veliu u mashtrua nga veprimet e të dënuarit tjetër A.R., meqë nuk e kishte ditur dallimin mes njësisë matëse “fjalë” dhe “karakter” dhe pasojave që shkaktohen nga ky ndryshim”.

58. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, po ashtu pretendoi se në veprimet e tij nuk janë formuar tiparet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar, meqë me asnjë veprim konkret nuk ka vënë në lajthim shërbimin e pagesave dhe as që është ballafaquar me këtë shërbim me rastin e pagesave, kurse as raportet e pagesave nuk janë bërë nga ai por nga komisionet profesionale dhe në bazë të këtyre raporteve është bërë pagesa të dënuarit A.R.. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore përkitazi me këto fakte vendimtare nuk ka dhënë arsye në aktgjykimin e saj e në këtë mënyrë aktgjykimi është bërë juridikisht i paqëndrueshëm dhe i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me nenin 384 (Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale), paragrafi 1, nënpragrafi 1.12 lidhur me paragrafin 6 të nenit 370 (Përmbajtja dhe forma e Aktgjykimit me shkrim) të KPPK-së.

(ii) *Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal*

59. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendoi se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore është bërë cilësim i gabuar i veprës penale, për arsye se sipas tij “kemi të bëjmë me falsifikimin e dokumentit zyrtar të paraparë me dispozitën e nenit 248 të KPK-së [Kodin e Përkohshëm Penal] e assesi me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor”.

60. Parashtruesi i kërkesës, në vijim pretendoi se Gjykata e Apelit nuk i kishte evituar shkeljet e gjykatës se shkallës së parë përkitazi me kërkesën pasurore juridike dhe udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil, dhe si rrjedhojë Gjykata e Apelit ka vënë në dilemë gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e Gjykatës Themelore përkitazi me dëmin e shkaktuar.
61. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit “ [...] në rastin e matjes se dënimit nuk kanë marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese përkatësisht rrethanat personale, bashkëpunimin e të dënuarit me organet e drejtësisë dhe faktin se kjo çështje është zbuluar me kontributin e të dënuarit i cili ka parandaluar dëmin më të madh Universitetit të Prishtinës”.
62. Më 29 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për plotësimin e kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Në këtë kërkesë, parashtruesi kishte pretenduar se Aktgjykimi [PAKR. Nr. 528/2018] i 16 prillit 2019 i Gjykatës së Apelit, ishte nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për arsye se “përbërja e Kolegjit vendimmarrës të Gjykatës së Apelit ishte identike me kolegjin që kishte vendosur edhe herën e parë në rastin e tij përmes Aktgjykimit [PAKR. Nr. 27/2018] të 2 majit 2018”. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, respektivisht rastit KI24/17, parashtrues i kërkesës *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 17 majit 2019.
63. Më 27 gusht 2019, Prokurori i Shtetit përmes shkresës [KMLP II. Nr. 176/2019] kishte parashtruar përgjigje ndaj kërkesës së parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. Në përgjigjen e tij, Prokurori kishte theksuar se “gjykata e shkallës së parë e gjithashtu edhe ajo e dytë nuk kanë bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal ashtu siç është përshkruar dhe arsyetuar në mënyrë të detajuar më lartë”.
64. Më 30 shtator 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. Nr. 253/2019] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
65. Gjykata Supreme në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave penale, vlerësoi se:

“Në rastin konkret del të jetë i pakontestueshëm fakti se mes Universitetit të Prishtinës përkatësisht Zyrës së Prokurimit, të përfaqësuar nga [parashtruesi i kërkesës] dhe Operatorit Ekonomik "Instituti i Studimeve Ndërkombëtare" në Tirane, i përfaqësuar nga ana e të dënuarit tjetër A.R. është lidhur kontrata me nr.43/08 e datës 05.12.2008, për përkthimin e librave të lëmisë legale për nevojat e UP-së, kurse në nenin 17 është specifikuar se çmimi i kontratës për njësi ishte "1000 fjalë 12.65 €" e cila kontratë ishte nënshkruar nga palët kontraktuese përkatësisht tani i të dënuarit. Kontrata me numër dhe datë të njëjtë është ndryshuar në nenin 17 të saj në atë mënyrë që çmimi i kontratës për njësi nga "1000 fjalë 12.65€" është ndryshuar në "1000 karaktere 12.65 €", e që është nënshkruar nga te

dënuarit dhe si pasojë e këtij ndryshimi qartazi ka ndryshuar edhe shuma e pagesës. Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është paraqitur arsyetim përkitazi me faktet vendimtare, konkretisht në faqen e 18 të këtij aktgjykimi është përshkruar fakti se [parashtruesi i kërkesës] ka nënshkruar në urdhrin për blerje të datës 07.09.2009 dhe bazuar në këtë edhe është iniciuar pagesa në shumë të përgjithshme prej 87.541,80 e sipas së cilës është bërë urdhër për pagesë dhe në këtë mënyrë është arritur që "ISN" nga Tirana të cilën e përfaqësonte i dënuari tjetër A.R. të përfitoj dobi pasurore të kundërligjshme dhe e cila pagese ka qenë rezultat i ndryshimit të nenit 17 të kontratës nga njësia matëse "1000 fjalë" në njësinë matëse "1000 karaktere".

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj drejtë ka konstatuar se në veprimet e [parashtruesit të kërkesës] janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK-së, pasi që [parashtruesi i kërkesës] kishte cilësinë e personit zyrtar siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 107 par.1 nënpar.1.1 të KPK-së, meqë ishte i zgjedhur për të përfaqësuar UP-në, përkatësisht zyrën e prokurimit dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të palës tjetër ka bërë prezantimin e rremë të raportit përkatësisht ka vënë në lajthim personin për të bërë pagesë të kundërligjshme pasi që paraprakisht ishte ndryshuar neni 17 i kontratës prej njësisë "1000 fjalë 12.65 €" në "1000 karaktere 12.65 €" dhe si pasojë e këtij ndryshimi do të realizoheshin pagesa më të larta të përthimit të teksteve universitare."

66. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal, respektivisht nenin 385, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të KPPK, Gjykata Supreme vlerësoi se ky pretendim është i pabazuar. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme duke ju referuar arsyetimit të dhënë nga Gjykata Themelore konstatoi se "[...] nuk kemi të bëjmë me vepër penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar nga neni 248 të KPK-së, por me vepër penale mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK-se edhe pse kontrata është ndryshuar por ky ndryshim përkatësisht ndërhyrje në nenin 17 të kontratës është bërë me qëllim që palës tjetër ti mundësoj përfitim të kundërligjshëm pasuror që do të rezultonte në përthimin e një numri më të vogël të librave".
67. Në vijim, Gjykata Supreme vlerësoi se Gjykata e Apelit "[...] me rastin e udhëzimit që pala e dëmtuar kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil nuk e ka cenuar aspektin e kualifikimit të kësaj vepre penale meqë siç është theksuar në faqen e 13 të aktgjykimit të kësaj gjykate [Gjykatës së Apelit] se element cilësues është dobia pasurore në vlerë që tejkalon shumë prej 5000 € dhe se vepra penale ka rezultuar me dobi pasurore në këtë vlerë. Përkundër faktit se është i saktë pretendimi se përfaqësuesi i UP-së si palë e dëmtuar nuk kishte parashtruar kërkesë pasurore juridike, kurse gjykata e shkallës së dytë palën e dëmtuar e kishte udhëzuar në kontest civil dhe kjo ishte si rezultat i faktit se gjykata e shkallës së parë kishte obliguar të dënuarit për kompensimin e dëmit, megjithatë kjo nuk kishte ndikim në ligjshmërinë e aktgjykimeve të kundërshtuara".
68. Në lidhje me pretendimin përkitazi me lartësinë e dënimit, Gjykata vlerësoi se Gjykata e Apelit "[...] ka vepruar brenda kompetencave të saj me rastin e

shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe me këtë rast është në diskrecionin e saj që në rast të konstatimit se gjykata e shkallës së parë nuk ka shqiptuar dënim adekuat, të ndryshoj dënimin përkatësisht të caktoj dënim më të rëndë siç ka vepruar në rastin konkret duke aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Me këtë rast gjykata e shkallës së dytë ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta ashtu që në faqen e 12 dhe 13 të aktgjykimit të saj ka arsyetuar veçanërisht se cilat kanë qenë rrethanat të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit të tillë dhe të cilat rrethana janë arsyetuar në harmoni me dispozitën e nenit 370 par.7 dhe 8 të KPPK-së, dhe për më tepër, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore, që në këtë rast nuk ka ndodhur”.

69. Në fund, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, të ngritur përmes kërkesës për plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë se në Gjykatën e Apelit ka vendosur i njëjti kolegji, Gjykata Supreme vlerësoi se ky pretendim *“ ishte i pabazuar pasi që nuk paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale fakti se pas kthimit të lëndës në rivendosje të bëhet ndryshimi i kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë. Duke e pasur parasysh faktin se anulimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ishte bërë vetëm për shkak të mos njoftimit të palëve për seancën e shqyrtimit në gjykatën e shkallës së dytë dhe se kjo shkelje ishte evituar në rivendosje nga ana e gjykatës së shkallës së dytë”.*
70. Si përfundim, Gjykata Supreme konstatoi se aktgjykimet e kundërshtuara të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

71. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar janë cenuar: (i) parimi i kontradiktoritetit dhe (ii) parimi i barazisë së palëve në procedurë; (iii) parimi i sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si (iv) dhe parimi i prezumimit të pafajësisë dhe mungesës së “mbrojtjes së veçantë”.

(i) Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procedurë

72. Sa i përket cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk ka pasur njohuri që Prokuroria e Shtetit përmes shkresës [KMLP.II. nr.176/2019] së 27 gushtit 2019, kishte propozuar që kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar. Sipas tij, ai është njoftuar për ekzistimin e kësaj shkrese vetëm pas publikimit të Aktgjykimit [Pml. Nr. 253/2019] të 30 shtatorit 2019, të Gjykatës Supreme. Në

këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës specifikon se nuk ka pasur mundësi t'i parashtrojë kundërshtimet e tij ndaj atyre të Prokurorisë së Shtetit.

73. Lidhur me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht rasteve KI108/10, KI103/10 dhe KI10/14, duke nënvizuar se *“në të gjitha këto raste Gjykata [Kushtetuese] ka pasur qëndrim të njëtrajtshëm”* ku parashtruesit duhet të vendosen në pozicion të barabartë me Prokurorin e Shtetit.
74. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së *Grozdanoski kundër ish-RJM*, kërkesa nr. 2150/03, Aktgjykim i 31 majit 2007, që sipas tij është i ngjashëm me rastin e tij, duke nënvizuar se *“GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6, për shkak se Gjykata Supreme e atij shteti nuk i kishte dorëzuar parashtruesit shkresat e dorëzuara nga Prokuroria e Shtetit”*.
75. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij ai *“është vendosur në pozicion të pabarabartë ndaj Prokurorisë së Shtetit, sepse për ekzistimin e një parashtruese të dorëzuar nga ky organ, parashtruesi është njoftuar vetëm pas publikimit të Aktgjykimit [Pml. Nr. 253/2019] të datës 30.09.2019”*.
76. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata Supreme ka shkelur parimin e kontradiktoritetit dhe i ka mohuar parashtruesit të drejtën për të parashtruar argumentet e tij, kundër pretendimeve të Prokurorisë së Shtetit.”* Në lidhje me këtë, parashtruesi konsideron se *“[...] autoritetet gjyqësore duhet të kenë kujdes që pozicionin e Prokurorit të Shtetit ta trajtojnë në cilësinë e palës së barabartë në procedurë dhe të mos i ofrojnë përparësi ndaj palës tjetër, e cila që në fillim është në pozicion faktik të pabarabartë për shkak se ka përballë një autoritet publik”*.
77. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht thekson se *“parimi i barazisë së palëve në procedurë”* është i zbatueshëm përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
78. Në këtë kontekst parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së *Borgers kundër Belgjikës*, rast ky i cili sipas tij *“parashtruesi [i këtij rasti konkret] ishte penguar që t'i përgjigjej konkluzioneve të zëvendës kryeprokurorit të përgjithshëm.”* Në kontekst të këtij rasti, parashtruesi i kërkesës arsyeton se *“[...] elementi i pabarazisë argumentohet me faktin se atij jo vetëm që i është pamundësuar parashtrimi i komenteve të tij kundër “mjetit juridik” të parashtruar nga Prokuroria e Shtetit në Gjykatën Supreme, por edhe me faktin e mospranimit të provave të dorëzuara nga ai, gjatë tërë procedurës penale”*.
79. Në këtë linjë argumentimi, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk i kanë pranuar si prova komunikimet elektronike të cilat ishin kryesore për përcaktimin e pafajësisë së tij, nën arsyetimin se ato paraqesin prova të cilat janë marrë pa vendim përkatës gjyqësor dhe pa iu nënshtruar ekspertizës. Në dritën e këtij pretendimi përkitazi me mospranimin e provave të propozuara nga ai nga gjykatat e rregullta, parashtruesi i kërkesës pretendon edhe interpretim dhe zbatim qartazi arbitrar të ligjit.

80. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që pretendimet nëse ligji dhe faktet janë interpretuar dhe zbatuar në kundërshtim me garancitë e një procesi të drejtë dhe të paanshëm të shqyrtohen nën dritën e vendimeve të GJEDNJ-së: në rastet *Waldberg kundër Turqisë*, kërkesa nr. 22909/93, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1995; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, kërkesa nr. 184/02, Aktgjykim i 11 janarit 2007; *Khamidov kundër Rusisë*, kërkesa nr. 72118/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2007, raste në të cilat, sipas parashtruesit GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak të interpretimit dhe zbatimit arbitrar të ligjit. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se është detyrë e Gjykatës që të mbrojë të drejtën e tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas praktikës së GJEDNJ-së në rastin *Koshoglu kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 48191/99, Aktgjykim i 10 majit 2007.
81. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson që provat të cilat merren pa një vendim gjyqësor duhet të shpallen të papranueshme kur ato dorëzohen nga Prokuroria e Shtetit, jo atëherë kur ato dorëzohen nga pala në procedurë. Sipas tij, legjislacioni në fuqi nuk parasheh asnjë kufizim në lidhje me të drejtën e palës së akuzuar që të ofrojë prova dhe argumente përmes të cilave e dëshmon pafajësinë e tij. Rrjedhimisht, sipas tij është në kompetencën e gjyqësorit të rregullt që për çështje të vërtetësisë së komunikimit (provës së papranueshme) të urdhërojë ekspertizë dhe të vërtetojë origjinalitetin e atyre provave (komunikimit elektronik).
82. Në kontekst të pretendimit të tij përkitazi me administrimin e provave, parashtruesi i kërkesës e vë theksin në pretendimin e tij se prova e paraqitur nga ana e tij, përkatësisht Vendimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës i 28 dhjetorit 2007 për përcaktimin e çmimit kushtues të shërbimeve të përthimit, nuk është shqyrtuar fare nga Gjykata. Rëndësia e pranimin të kësaj prove, si dhe e-mailat e dorëzuar, sipas tij kanë rëndësi të jashtëzakonshme, sepse me pranimin e këtyre provave do të arrihej një rezultat tjetër nga ai që ka arritur gjyqësori i zakonshëm.
83. Parashtruesi i kërkesës në vijim konteston pranimin si provë nga ana e gjyqësorit, të *“një shkresë të cilën e konsideron si kontratë”* dhe mbi bazën e së cilës merret vendimi për dënimin e tij dhe se sipas tij, ai dokument nuk gjendet as në arkivin e Universitetit të Prishtinës dhe as në Ministrinë e Financave dhe se e njëjta nuk është përdorur asnjëherë nga ana e tij për të ekzekutuar ndonjë pagesë.
84. Mbi këtë bazë, parashtruesi i kërkesës pretendon se duke i refuzuar *“në mënyrë arbitrare –përmes interpretimit të gabuar dhe kundër kushtetues të pranueshmërisë së provave të dorëzuara – parashtruesit i është mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, konkretisht parimi i barazisë [së armëve] në procedurë”*.

(ii) Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor

85. Në lidhje me parimin e sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim gjyqësor të arsyeshëm, parashtruesi i kërkesës pretendon se asnjë nga pretendimet e tij pas 19 nëntorit 2018, respektivisht pas kthimit të rastit të tij në

rivendosje në Gjykatën e Apelit nuk janë shqyrtuar dhe arsyetuar nga gjykatat e rregullta.

86. Parashtruesi i kërkesës specifikon se *“fakti që [...] deklaroi Gjykatës se “asnjë pretendim nuk është trajtuar nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme” si dhe fakti që ja ka bashkëngjitur të gjitha shkresat e dorëzuara, janë arsye të mjaftueshme që Gjykata të shqyrtojë nëse pretendimet e përmendura janë trajtuar ose jo. Përsëritja e këtyre pretendimeve dhe në këtë kërkesë kushtetuese, do të konsiderohej përsëritje e pretendimeve të ngritura para gjykatave të zakonshme, dhe do të rezultonte me pretendime për një instancë të katërt. Prandaj parashtruesi nuk dëshiron të rrëshqet në atë sferë, sepse konsideron se pretendimet e tij duhet të mbesin në nivel kushtetues – dhe se është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë argumentet kushtetuese të ngritura nga ai në lidhje me mos-arsyetim të pretendimeve të tij”*.
87. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon se arsyetimi i Aktgjykimit [Pml.nr.253/2019] të 30 shtatorit 2019, i Gjykatës Supreme është kundërthënës.
88. Parashtruesi i kërkesës ndër të tjera thekson se në seancën e 16 prillit 2019 në Gjykatën e Apelit nuk është mbajtur me rregull procesverbali, i cili është detyrim që buron nga Kodi i Procedurës Penale dhe i cili i mundëson atij që të dëshmojë se i *“ka ngritur pretendimet tjera, të cilat nuk janë të përmendura në parashtruesit e dorëzuara”*. Për më tepër, ai thekson se përkundër faktit që nuk është mbajtur procesverbal, Gjykata Supreme në Aktgjykimin [Pml.nr.253/2019] të 30 shtatorit 2019, ka theksuar se *“në bazë të shkresave të lëndës, konstatohet se është mbajtur procesverbal”*.
89. Përfundimisht, sa i përket tërësisë së pretendimeve për vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme *“[...] ka nxjerrë një vendim arbitrar dhe kontradiktor, ngjashëm me rastin e Gjykatës KI31/17, me parashtrues Shefqet Berisha, kur Gjykata Themelore në Prishtinë kishte marrë vendim i cili qartazi binte ndesh me gjendjen faktike të konstatuar përmes shqyrtimit të lëndës në atë rast. Një ndër arsyet e konstatimit të shkeljes së të drejtës për gjykim të rregullt, në rastin e parashtruesit Shefqet Berisha, ishte pikërisht fakti i falsifikimit të vendimeve gjyqësore.”* Sipas parashtruesit të kërkesës, në mënyrë pothuajse identike, përmes një vendimi të falsifikuar, atij i është mohuar e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke rezultuar me një gjykim arbitrar ndaj tij.

(iii) Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe mungesës së “mbrojtjes së veçantë”

90. Ndërsa, në lidhje me parimin e *prezumimit të pafajësisë* dhe mungesës së mbrojtjes së veçantë, parashtruesi i kërkesës konsideron se gjatë tërë procedurës penale është vendosur në një pozicion i cili ka cenuar në vazhdimësi parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi që rasti kishte ndjeshmëri të lartë, si rezultat i personave të tjerë të përfshirë në këtë rast dhe presionit të publikut dhe mediave, duke rezultuar me ndikim në rastin e tij. Ai pretendon se presioni ndaj gjykatave të rregullta ishte shtuar me rastin e inicimit të kallëzimeve penale ndaj kryeprokuroorit të shtetit dhe prokurores D.H., nga palët tjera të përfshira në procedurë.

91. Parashtruesi i kërkesës referohet në rastin *Kuzmin kundër Ruisë*, ku GJEDNJ kishte konstatuar se një fushatë “plot vrer” mund ta dëmtojë rregullsinë e një procesi duke ndikuar mbi opinionin, e për rrjedhojë edhe anëtarët e një trupi gjykues.
92. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se fakti që nuk janë shqyrtuar pretendimet e tij të dorëzuara përmes avokatëve të tij dhe mos mbajtja e procesverbalit, e ka privuar atë nga mbrojtja e veçantë e cila duhet të ju ofrohet sinjalizuesve. Më tej ai pretendon që gjyqësori i zakonshëm nuk e ka trajtuar as faktin që ishte pikërisht ai i cili e njoftoi menaxhmentin e Universitetit të Prishtinës mbi “parregullsitë e kontratës”.
93. Parashtruesi i kërkesës në mbështetje të këtij pretendimi gjithashtu i referohet rastit *Guja kundër Moldavisë* (kërkesa nr. 14277/04, Aktgjykim, i 12 shkurtit 2018, paragrafi 72) në të cilin rast GJEDNJ thekson se “Gjykata kështu çmon se, sinjalizimi nga një nëpunës civil ose një punonjës në sektorin publik për sjellje të jashtëligjshme ose jo të rregullta në vendin e punës, në rrethana të caktuara, duhet të gëzojë mbrojtje. Një mbrojtje e tillë i jepet punonjësit ose nëpunësit civil i cili është i vetmi person, ose pjese e një kategorie të vogël personash, të vetëdijshëm për atë që po ndodh në vendin e punës dhe të vetmit që mund të veprojnë në interes të publikut duke njoftuar punëdhënësin ose publikun e gjerë”.
94. Për më tepër, sipas parashtruesit të kërkesës në të njëjtin vendim GJEDNJ thekson po ashtu se “Lidhur me detyrimin e punonjësve për konfidencialitet të përmendur më sipër, informohet së pari eprori ose ndonjë organ ose autoritet tjetër kompetent. Vetëm kur një gjë e tillë është qartësisht e pamundur, si alternativa e fundit duhet të konsiderohet bërja publike e informacionit” (shih rastin e GJEDNJ-së *Guja kundër Moldavisë*, cituar më lartë, paragrafi 73).
95. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se është privuar nga mbrojtja të cilën e ka kërkuar përmes parashtresave të dorëzuara nga avokatët e tij dhe të cilat pretendon se i ka ngritur në seancën e 16 prillit 2019, të zhvilluar në Gjykatën e Apelit. Prandaj mos mbajtja e procesverbalit ia ka pamundësuar atij që t’i dëshmojë Gjykatës “se në të njëjtën seancë janë ngritur fjalë për fjalë, këto pretendime, sikurse në këtë kërkesë.” Sipas tij, në formulime të ngjashme, por pa referencë në praktiken e GJEDNJ-së, gjenden në shkresat e dorëzuara përmes avokatëve të tij.

Kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme

96. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka paraqitur kërkesë për masë të përkohshme, ku i referohet praktikës së GJEDNJ-së, ku sipas tij: “GJEDNJ në vendimet e saj përmes të cilave ka ankoruar rëndësinë e vendosjes së masave të përkohshme ka theksuar se masat e përkohshme i lejojnë Gjykatës që të shqyrtojë efektivisht kërkesën e parashtruesit, por po ashtu të sigurojë se mbrojtja e akorduar ndaj tij është po ashtu efektive” (shih vendimet e GJEDNJ-së në *Mamatkulov dhe Askarov kundër Turqisë* [DHM], kërkesa nr. 46827/99 dhe nr. 46951/99, paragrafi 12; *Paladi kundër Moldavisë* [DHM], kërkesa nr. 39806/05, paragrafi 86). Në lidhje me argumentimin e tij për miratim të masës së përkohshme,

parashtruesi i kërkesës konsideron se i ka ofruar Gjykatës, jo vetëm një arsytim *prima facie* rreth meritave të rastit, por ka shpërfaqur qartazi arbitraritetin e autoriteteve gjyqësore dhe shkeljen e lirive dhe të drejtave të tij themelore.

97. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata ka argumente të mjaftueshme para saj që të aprovojë kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme dhe të pezullojë zbatimin e vendimeve gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës, në këtë rast i referohet rastit të Gjykatës [KI78/12, parashtrues *Bajrush Xhemajli*, Vendimi për vendosjen e masës së përkohshme, i 21 shtatorit 2012, dhe Vendimi për vazhdimin e masës së përkohshme, i 24 janarit 2013], në të cilin, sipas tij, arsyet për vendosjen e masës së përkohshme janë të njëjta si në rastin e tij.
98. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) që të shpallë kërkesën të pranueshme, të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së; (ii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Pml.nr.253/2019] e 30 shtatorit 2019, të Gjykatës Supreme dhe të gjitha vendimet e lidhura me këtë procedurë, të kthejë rastin në rivendosje në Gjykatë Themelore; (iii) si dhe të aprovojë kërkesën për masë të përkohshme dhe të pezullojë ekzekutimin e vendimeve.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një veprë penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Kodi i Përkohshëm Penal [Rregullore e UNMIK-ut 2003/25]

Neni 23

BASHKËKRYERJA

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.

Neni 341

MASHTRIMI NË DETYRË

[...]

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Neni 87

Përkufizimi i masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit gjatë hetimit paraprak

Për qëllime të këtij Kapitulli:

1. Masa të fshehta ose teknike të vëzhgimit dhe hetimit ("masa sipas këtij kapitulli") do të thotë secila nga këto masa të mëposhtme:

- 1.1. vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video;*
 - 1.2. monitorim i fshehtë i bisedave;*
 - 1.3. kontrollim i dërgesave postare;*
 - 1.4. përgjimi i telekomunikimeve dhe duhet të përdoret Lexuesi – IMSI – Identifikimi Ndërkombëtar i Shfrytëzuesit Mobil;*
 - 1.5. përgjim i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik;*
 - 1.6. dërgim i kontrolluar i dërgesave postare;*
 - 1.7. shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes;*
 - 1.8. blerje e simuluar e ndonjë sendi;*
 - 1.9. stimulim i veprës së korrupsionit;*
 - 1.10. hetim i fshehtë;*
 - 1.11. regjistrim i thirrjeve telefonike; dhe*
 - 1.12. zbulim i të dhënave financiare.*
- [...]*

Neni 88

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike, regjistrimi i thirrjeve telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare mund të urdhërohet kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:

1.1. ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe

1.2. informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

2. Regjistrimi i bisedave telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare po ashtu mund të urdhërohet kundër personave, përpos të dyshuarit, kur kushti në nën-paragrafin 1.1. të paragrafit 1. të këtij neni vlen për të dyshuarin dhe kur plotësohet parakushti nga paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. i këtij neni dhe ekziston dyshim i bazuar se:

2.1. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit apo që merr pjesë në transaksionet financiare të të dyshuarit; ose

2.2. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë.

3. Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, ndërhyrja e komunikimeve me anë të

rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerja e simuluar e ndonjë sendi, simulimi i një vepre të korrupsionit apo hetimi i fshehtë mund të urdhërohen kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse:

3.1. ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale nga neni 90 i këtij Kodi;

3.2. informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merret me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

4. Kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve ose përgjimi i komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik po ashtu mund të urdhërohen kundër personit, përpos të dyshuarit, kur kushti nga paragrafi 3. nën-paragrafi 3.1. i këtij neni vlen për të dyshuarin dhe kur plotësohet parakushti nga paragrafi 3. nën-paragrafi 3.2. i këtij neni dhe ekziston dyshim i bazuar se:

4.1. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit; ose

4.2. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë ose ka qasje në sistem kompjuterik.

Neni 435

Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga kolegji i Gjykatës Supreme

1. Për kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë vendos Gjykata Supreme e Kosovës në seancë të kolegjit.

2. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendim e hudh kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nëse kërkesa është e papranueshme ose është paraqitur jashtë afatit nga neni 434, paragrafi 2. i këtij Kodi. Në të kundërtën, kopjen e kërkesës ia dërgon palës kundërshtare, e cila në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës mund të paraqesë përgjigje në kërkesë.

3. Para marrjes së vendimit mbi kërkesën, gjyqtari raportues, sipas nevojës, mund të kërkojë raport për shkeljet e pretenduara ligjore.

4. Varësisht nga përmbajtja e kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës mund të caktojë shtyrjen ose ndërprerjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

99. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

100. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

101. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatit]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

102. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

Rregulli 39
[Kriteret e Pranueshmërisë]

*(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër Aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

103. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin Pml. nr. 253/2019 të 30 shtatorit

2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i ka sqaruar pretendimet e tij për ato të drejta dhe liri që ai pretendon se i janë shkelur përmes vendimeve gjyqësore, në pajtim me kushtet që kërkohen nga neni 48 i Ligjit si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

104. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

105. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkatësisht parashtruesi specifikon se ne rastin e tij janë cenuar: I. Parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë, (i) si rezultat i mosnjoftimit të tij për shkresën e Prokurorit të Shtetit dhe (ii) parimi i barazisë së armëve për shkak të mospranimit të provave nga gjykata e rregullta; II. Parimi i sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si dhe III. Parimi i prezumimit të pafajësisë dhe mungesës së “mbrojtjes së veçantë”.

106. Prandaj, Gjykata në vijim, pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës do t'i shqyrtojë në dritën e garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procedurë

107. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se në procedurat para gjykatave të rregullta si rezultat i mosnjoftimit nga Gjykata Supreme për shkresën [KMLP.II. nr.176/2019] e 27 gushtit 2019 të Prokurorit të Shtetit është shkelur parimi i kontradiktoritetit dhe ai i barazisë së armëve.
108. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se si rezultat i refuzimit të gjykatave të rregullta për pranimin e provave të propozuara nga ai është shkelur parimi i barazisë së armëve në procedurë.
109. Rrjedhimisht, në dritën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve.

110. Në fund, Gjykata gjatë shqyrtimit dhe elaborimit të parimeve të përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse rastet e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, të përmendura nga parashtuesi në kërkesën e tij i referohen rrethanave të ngjashme faktike dhe juridike si ato në rastin e tij dhe po ashtu do të vlerësojë nëse këto raste janë të aplikueshme në rastin e tij.
- a. *Parimet e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve*
111. Gjykata duke iu referuar edhe praktikës së GJEDNJ-së, fillimisht rithekson se parimi i “barazisë së armëve” është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Borgers kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 12005/86, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 24).
112. GJEDNJ dhe Gjykata në praktikën gjyqësore ka theksuar se parimi i “barazisë së armëve”, kërkon “ekuilibër të drejtë midis palëve” ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare (shih rastet e GJEDNJ-së *Yvon kundër Francës*, kërkesa nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, kërkesa nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33 shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 140, *Grozdanoski kundër ish-RJM*, kërkesa nr. 2150/03, Aktgjykim i 31 majit 2007, shih po ashtu rastet e Gjykatës, KI52/12, parashtues Adije Iliri, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtues Shaban Mustafa, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40).
113. Gjykata më tej rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar se kërkesa e barazisë së armëve, në kuptim të një ekuilibri të drejtë midis palëve, vlen në parim si për raste civile ashtu edhe për ato penale (shih *Dombo Beher B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33).
114. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se gjykimi i drejtë gjithashtu përfshin të drejtën për gjykimin në pajtim me “parimin e kontradiktoritetit”, parim i cili është i ndërlidhur me parimin e “barazisë së armëve”. Në këtë kontekst, në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm, veçanërisht në lidhje me rëndësinë që i kushtohet paraqitjeve dhe rritjes së vëmendjes apo ndjeshmërisë së publikut ndaj administrimit të drejtë të drejtësisë (shih rastin *Borgers kundër Belgjikës* të cituar më lartë, paragrafi 24).
115. Për më tepër, në kuadër të procedurës penale GJEDNJ ka nënvizuar se: “Është një aspekt themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë që procedurat penale, përfshirë elementet e procedurave të tilla që kanë të bëjnë me vetë procedurën, duhet të jenë në pajtim me parimin e kontradiktoritetit dhe se duhet të ekzistojë barazia e armëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes” (shih rastin e GJEDNJ-së *Leas kundër Estonisë*, kërkesa nr. 59577/08, Aktgjykim i 6 marsit 2012, paragrafi 77). Rrjedhimisht, përkitazi me parimin e kontradiktoritetit GJEDNJ theksoi se, në procedurë penale, si prokuroria ashtu edhe mbrojtja duhet të kenë mundësinë që të kenë njohuri dhe të bëjnë komente për të gjitha vërejtjet dhe

provat e paraqitura nga pala tjetër (shih rastin *Brandstetter kundër Austrisë të cituar më lartë*, paragrafi 67).

116. Përderisa, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me paraqitjen e provave dhe pranueshmërinë e tyre, Gjykata po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, në parim ka theksuar se “*Ndonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai nuk përcakton megjithatë rregulla për pranueshmërinë e provave si të tillë, një fushë kjo që u përket për këtë arsye në radhë të parë të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare*” (shih rastet e GJEDNJ-së *Schenk kundër Zvicrës*, paragrafët 45-46 dhe *Heglas kundër Republikës Çeke*, paragrafi 84).
 117. Megjithatë, GJEDNJ ka nënvizuar se aspekti që duhet shqyrtuar në këso raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih rastin e GJEDNJ-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34; *P.G. e J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 76; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 42).
- b. *Zbatimi i këtyre parimeve në rastin e parashtruesit të kërkesës*
118. Gjykata, fillimisht rikujton se pretendimin përkitazi me mos njohurinë e tij për ekzistimin e shkresës [KMLP.II. nr.176/2019], të 27 gushtit 2019 të Prokurorit të Shtetit përmes të cilës kishte propozuar që kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruar kundër Aktgjykimit [PKR. Nr. 432/15] të 18 tetorit 2017 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAKR. Nr. 528/2018] të 16 prillit 2019 të Gjykatës së Apelit, të refuzohet si e pabazuar në mënyrë specifike e ndërlidh me cenimin e parimit të kontradiktoritetit. Megjithatë në pjesën e kërkesës së tij, që i referohet pretendimeve për cenim të barazisë së armëve, Gjykata rikujton se përkitazi me “propozimin e Prokurorit të Shtetit për refuzim të kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë”, të shprehur përmes shkresës [KMLP.II. nr.176/2019] së 27 gushtit 2019, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së *Borgers kundër Belgjikës*, në të cilin rast GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të barazisë së armëve në procedurë.
 119. Së dyti, Gjykata rikujton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për mospranimin e provave materiale të propozuara nga ai në procedurë pranë gjykatave të rregullta, respektivisht korrespondencën elektronike dhe Vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, e ndërlidh me parimin e barazisë së armëve.
 120. Ndërsa përkitazi me arsyetimin e gjykatave të rregullta për mospranimin e korrespondencës elektronike si provë materiale, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe aplikuar ligjin qartazi në mënyrë arbitrare. Parashtruesi gjithashtu thekson pranimin nga ana e gjykatave të “*një shkresë të cilën e konsideron si kontratë*” mbi bazën e së cilës merret vendimi për dënimin e tij e sipas parashtruesit të kërkesës ai dokument nuk gjendet as në arkivin e Universitetit të Prishtinës dhe as në Ministrinë e Financave dhe se e njëjta nuk është përdorur asnjëherë nga ana e tij për të ekzekutuar ndonjë pagesë.

121. Rrjedhimisht, në dritën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të shqyrtojë pretendimin e tij për cenim të: (i) parimit të kontradiktoritetit dhe atij të barazisë së armëve si rezultat i mosnjoftimit të tij lidhur me shkresën e Prokurorit të Shtetit; (ii) Parimit të barazisë së armëve si rezultat i mospranimit të provave materiale të propozuara nga ai në procedurë pranë gjykatave të rregullta, respektivisht korrespondencën elektronike dhe Vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës.

(i) Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe atij të barazisë së armëve si rezultat i mosnjoftimit të tij lidhur me shkresën e Prokurorit të Shtetit

122. Gjykata rikujton se pas parashtrimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, të parashtruar më 9 korrik 2019, Prokurori i Shtetit përmes shkresës [KMLP.II. nr.176/2019] të 27 gushtit 2019 kishte propozuar që kërkesa e parashtruesit të refuzohet si e pabazuar. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se për ekzistimin e kësaj shkrese ishte njoftuar pasi që kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht vëren se Prokurori i Shtetit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nuk kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mirëpo pasi që ishte njoftuar përkitazi me paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga parashtruesi i kërkesës, më 27 gusht 2019 kishte dorëzuar “përgjigjen ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë”, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Ky fakt i paraqitjes së propozimit të Prokurorit të Shtetit përmes shkresës [KMLP.II. nr.176/2019] të 27 gushtit 2019 ishte reflektuar edhe në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme [Pml. Nr. 253/2019], të 30 shtatorit 2019 [e titulluar Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit] dhe përmbante edhe tekstin si në vijim: “Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, më shkresën KMLP. II. Nr. 176/2019 e datës 27.08.2019, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve të refuzohen si të pabazuara.”

123. Përkitazi me mos njohurinë e tij për ekzistimin e kësaj shkrese, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk ka pasur mundësi t'i parashtrojë përgjigjen apo kundërshtimet e tij kundër atyre të Prokurorit të Shtetit. Në kërkesën e tij, të parashtruar në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës në një rast, këtë përgjigje të Prokurorit të Shtetit e kishte cilësuar edhe si mjet juridik. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës kishte specifikuar se “Për më tepër, nga shtjellimi i mësipërm, parashtruesi rithekson se elementi i pabarazisë argumentohet me faktin se atij jo vetëm që i është pamundësuar parashtrimi i komenteve të tij kundër mjetit juridik të parashtruar nga Prokuroria e Shtetit në Gjykatën Supreme [...]”.

124. Fillimisht Gjykata i referohet rasteve të sipër cekura të Gjykatës, respektivisht rasteve, të cilat parashtruesi i kërkesës iu kishte referuar në kërkesën e tij.

125. Në rastin KI108/10 [parashtrues *Fadil Selmanaj*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2011] në kontest administrativ, parashtruesi i kërkesës nuk ishte njoftuar lidhur me padinë e ish-punëdhënësit të tij kundër Vendimit të Këshillit të Pavarur

Mbikëqyrës, të parashtruar në Gjykatën Supreme, i cili vendim kishte qenë në favor të parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës po ashtu nuk ishte njoftuar as përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, përmes së cilit padia e ish-punëdhënësit të tij ishte aprovuar dhe, rrjedhimisht vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, ishte anuluar. Gjykata konstatoi se nuk kishte dëshmi se parashtruesi ishte informuar për inicimin e procedurës administrative në Gjykatën Supreme, dhe në vijim duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ konstatoi se Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e shpalli të pavlefshëm, dhe rastin e ktheu për rivendosje në Gjykatën Supreme në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës.

126. Në rastin KI103/10 [parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim, i 12 prillit 2012] në procedurë civile, Komuna e Podujevës kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Supreme për revizion kundër aktgjykimeve të shkallëve më të ulta. Në të njëjtën kohë, Prokurori Publik, kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të njëjta të gjykatave më të ultë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabueshëm të drejtës materiale në Gjykatën Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme në praninë e Prokurorit të atëhershëm publik kishte aprovuar kërkesën për revizion të parashtruar nga Komuna e Podujevës, dhe po ashtu kishte aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori Publik, duke i anuluar aktgjykimet e shkallës më të ultë, në dëm të parashtruesit të kërkesës. Për këto veprime nuk kishte qenë i njoftuar parashtruesi i kërkesës, i cili në kërkesën e tij të parashtruar në Gjykatë, ndër të tjera kishte pretenduar shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës për arsye se “*palët në procedurë pranë Gjykatës Supreme nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë.*” Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj kishte shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së. Gjykata e kishte shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, duke e kthyer rastin për rivendosje në Gjykatën Supreme, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës.

127. Në rastin, KI10/14 [parashtrues *Shoqëria Aksionare Raiffeisen Bank S.H.A.*, Aktgjykim, i 20 majit 2014], Gjykata Supreme kishte vendosur që kërkesën e E.N. për revizion ta hedhë poshtë si të pasafatshme. Pas këtij Aktvendimi, E.N., kishte parashtruar kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme, për të cilën kërkesë, parashtruesi në cilësinë e palës në procedurë nuk ishte njoftuar nga Gjykata Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme kishte aprovuar kërkesën e E.N. për kthim në gjendje të mëparshme, dhe përmes të njëjtit Aktgjykim revizionin e E.N. e kishte pranuar si të themeltë, duke anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, në dëm të parashtruesit të kërkesës. Gjykata, duke ju referuar parimit të barazisë së armëve në procedurë, të konfirmuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, kërkesën e parashtruesit e kishte shpallur të pranueshme dhe kishte konstatuar shkelje të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata shpalli Aktgjykimin e kontestuar të

Gjykatës Supreme të pavlefshëm dhe e ktheu rastin për rivendosje në Gjykatën Supreme, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës.

128. Në vijim, Gjykata i referohet rastit të GJEDNJ-së *Borgers kundër Belgjikës*, të përmendur nga parashtruesi i kërkesës [kërkesa nr. 12005, Aktgjykim, i 30 tetorit 1991], të cilin do ta përmbledh shkurtimisht. Ankuesi, z. Borgers, u akuzua për falsifikim të dokumenteve. Në seancën e tij të apelit, fjala e fundit iu dha avokati i përgjithshëm (avocat général) një anëtar i zyrës së prokurorit i cili nuk ishte palë në gjyq, por detyra e tij ishte të rekomandonte gjykatën nëse apeli duhej lejuar apo jo. Avokati i përgjithshëm gjithashtu u lejua të merrte pjesë në diskutimet e gjykatës, ndërsa parashtruesi nuk ishte. Z. Borgers u ankua se pjesëmarrja e Avokatit të përgjithshëm në seancë dhe në diskutime shkelte barazinë e armëve pasi ai nuk ishte në gjendje të komentonte deklaratat e Avokatit Gjeneral. Gjatë zhvillimit të procedurës penale, përkatësisht në seancën shqyrtuese, të mbajtur në Gjykatën e Kasacionit, avokati i përgjithshëm kishte paraqitur propozimin e tij se kërkesa e parashtruesit, e parashtruar në këtë Gjykatë ishte e pabazuar. Për faktin që parashtruesi nuk kishte qenë i njoftuar paraprakisht përkitazi me propozimin e avokatit të përgjithshëm, ai gjatë kësaj seance shqyrtuese nuk kishte mundësi t'i përgjigjej propozimit të tij, si dhe më pas të ofronte vërejtjet e tij me shkrim në Gjykatë. Gjatë vlerësimit të kërkesës, GJEDNJ pranoi se avokati i përgjithshëm nuk ishte pjesë e ndjekjes penale dhe se funksioni i tij në procedurë ishte të ofronte vetëm këshilla të pavarura dhe të paanshme për Gjykatën e Kasacionit për çështjet ligjore të ngritura në këtë çështje dhe mbi konsistencën e praktikës gjyqësore të saj, pa pasur të drejtë vote gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes në koleg të gjyqtarëve. Në thelb, GJEDNJ kishte vlerësuar nëse pjesëmarrja e avokatit të përgjithshëm në diskutimet e Gjykatës së Kasacionit dhe fakti që parashtruesi nuk kishte mundësinë t'i përgjigjej parashtrësive të këtij të fundit ose t'i drejtohej Gjykatës së Kasacionit kishte cenuar parimin e barazisë së armëve në procedurë, dhe rrjedhimisht të drejtën e tij për një gjykim të drejtë. GJEDNJ konsideroi se “nuk mund të pranohet arsyetimin për kufizime të tilla në të drejtën e mbrojtjes. [...] Më tej dhe mbi të gjitha, pabarazia u rrit edhe më shumë nga pjesëmarrja e avokatit të përgjithshëm, në cilësinë e tij këshillëdhënëse, në diskutimet e Gjykatës. Ndiqja e kësaj natyre, e dhënë me objektivitet të plotë, mund të jetë e dobishme në hartimin e gjykimeve, megjithëse kjo detyrë i takon në radhë të parë vetë Gjykatës së Kasacionit. [...] (paragrafët 27-28 të Aktgjykimit). Rrjedhimisht, GJEDNJ përfundoi se “[...] duke pasur parasysh kërkesat që i referohen të drejtës së mbrojtjes, dhe parimin e barazisë së armëve, si dhe rolin e paraqitjes në përcaktimin nëse ato janë përmbushur, Gjykata konstaton shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së” (paragrafi 29 i Aktgjykimit).
129. Ndërsa, në rastin e GJEDNJ-së *Grozdanoski kundër ish-RJM*, të përmendur nga parashtruesi i kërkesës [kërkesa nr. 2150/03, Aktgjykim i 31 majit 2007] prokurori publik kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Parashtruesi, si palë në procedurë nuk ishte njoftuar kurrë lidhur me atë kërkesë, e cila kërkesë ishte aprovuar nga Gjykata Supreme, dhe e cila ishte e pafavorshme për parashtruesin. GJEDNJ-ja vlerësoi se dështimi procedural për të njoftuar palën tjetër e ka penguar atë nga pjesëmarrja në mënyrë efektive në procedurë para Gjykatës Supreme të ish-RJM. GJEDNJ konkludoi se, në procedurën civile, parimi i barazisë së armëve do të thotë që secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqes rastin e tij/saj nën

kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare.

130. Në rastin konkret , Gjykata rikujton se në bazë të kërkesës së saj për dorëzimin e informatave nga Gjykata Supreme, të 10 prillit 2020 dhe përsëritjes së kërkesës të 7 majit 2020, Gjykata i kishte kërkuar Gjykatës Supreme që ta informojë Gjykatën si në vijim: (i) nëse parashtruesi i kërkesës ka qenë i njoftuar lidhur me shkresën [KMLP.II. nr.176/2019] të 27 gushtit 2019 të Prokurorit të Shtetit, kjo për faktin se kjo informatë nuk gjendej në dosjen e rastit të pranuar nga Gjykata Themelore; (ii) që të dorëzojë kopjen e shkresës së lartcekur të Prokurorit të Shtetit; dhe (iii) sipas praktikës së Gjykatës Supreme, nëse në kuadër të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, a njoftohen palët përkitazi me shkresat e Prokurorit të Shtetit, përmes të cilës Prokurori i Shtetit propozon refuzimin e kërkesave të parashtruara nga pala për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.
131. Më 8 maj 2020, Gjykata Supreme kishte dorëzuar kopjen e kërkuar nga Gjykata të shkresës [KMLP.II. nr.176/2019] të 27 gushtit 2019 të Prokurorit të Shtetit. Ndërsa ndaj pyetjeve të Gjykatës nëse (i) parashtruesi i kërkesës ka qenë i njoftuar lidhur me shkresën [KMLP.II. nr.176/2019] të 27 gushtit 2019 të Prokurorit të Shtetit; dhe (ii) nëse në bazë të praktikës së Gjykatës Supreme dhe në kuadër të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, a njoftohen palët përkitazi me shkresat e Prokurorit të Shtetit, Gjykata Supreme ishte përgjigjur si në vijim:

Pranë kësaj Gjykate është zhvilluar dhe përfunduar procedura penale PML.nr.253/2019, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarve, Hakif Veliu dhe A.R të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.432/2015 të datës 18.10.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.528/2018 të datës 16.04.2019. Kërkesat janë refuzuar si të pa bazuara. Sa i përket çështjeve të parashtruara në kërkesë ju njoftoj se sipas dispozitës së nenit 435 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet obligimi i Gjykatës Supreme që vetëm kopjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, (në rastin konkret kërkesën në fjalë e kanë paraqit mbrojtësit e të dënuarve) ti përcillet palës kundërshtare (në këtë rast Prokurorit të Shtetit e që ashtu është veprua) e cila në afat prej 15 ditëve mund të paraqesë përgjigjeje në ankesë (ashtu edhe ka veprua prokurori i shtetit).

Meqenëse, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë vendoset në seancë të kolegjit në praktikën e deritashme të kësaj gjykate në asnjë rast nuk janë përcjell përgjigjet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë palës ushtruese të kërkesës pasi që këtë nuk e ka përcaktua as ligjdhënësi. Kësisoj, lidhur me përgjigjen e palës ligji nuk parasheh që pala tjetër ka të drejt në ndonjë kundërpërgjigje e që është logjikshme nga se procedura në këtë mënyrë nuk do ta ketë ndonjë epilog përfundimtar. Esenca është që pala e pakënaqur me aktgjykimit e gjykatave të shkalleve ma të ulëta ka të drejt të ushtroj kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndërsa pala kundërshtare siç u cek ma lartë mund të paraqes përgjigje në kërkesë dhe me kaq përfundon obligimi i gjykatës dhe konsiderohet se plotësohen kushtet procedurale për vendosje lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

132. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet edhe shkresës [KMLP.II. nr.176/2019] të 27 gushtit 2019 të Prokurorit të Shtetit, e titulluar “Përgjigje në Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë” përmes të cilës propozohet që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës dhe A.R [parashtrues në rastin KI230/19] kundër Aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit të refuzohen si të pabazuara.

133. Në përgjigjen e tij, Prokurori i Shtetit, arsyeton si në vijim:

Aktgjykimet e atakuara [Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe ai i Apelit] mbështeten në prova të administruara dhe drejtë të vlerësuara dhe se në këtë drejtim në arsyetim të këtyre aktgjykimeve janë paraqitur në mënyrë të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye merren si të provuara ose si të paprovuara, e ashtu që po në arsyetim të këtyre aktgjykimeve janë dhënë arsye të duhura dhe konkludime të qarta për të gjitha faktet relevante që kanë të bëjnë me fajësinë e të akuzuarve [parashtruesit të kërkesës dhe A.R]. Po ashtu, edhe gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e vet ka dhënë arsye të qarta e të plota përkitazi me konkludimin e gjykatës mbi pabazueshmërinë e pretendimeve ankimore të mbrojtësve të akuzuarve të ushtruara ndaj aktgjykimit të shkallës së parë. Se në bazë të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në bazë të korrespondencës elektronike të cekur më sipër, prokuroria konsideron se në mënyrë të sigurt vërtetohet se [parashtruesi i kërkesës], me dashje direkte dhe sipas marrëveshjes paraprake, kanë kryer veprën penale, mashtrimi në detyrë nga neni 341 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës, në mënyrë siç është përshkruar me detajisht në aktakuzën e prokurorisë. Po ashtu pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve të lartcekur, se me aktgjykimet e cekura është shkelur kodi penal, janë të pabazuara. Po ashtu edhe kodi penal drejtë është aplikuar kur në veprimet e të gjykuarve [parashtruesit të kërkesës dhe A.R.], është konstatuar se qëndrojnë elementet e veprës penale: Mashtrimi në detyrë në bashkëkryerje nga neni 341 par.3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës, andaj të dy gjykatat drejtë kanë vepruar edhe sa i përket provave të administruara, duke i vlerësuar ato veç e veç dhe të gjitha së bashku, e duke dhënë edhe arsye të mjaftueshme lidhur me provat, besueshmërinë dhe vlerën provuese të tyre. Prandaj, nga të gjitha të lartcekurat konsideroj se gjykata e shkallës së parë e gjithashtu edhe ajo e dytë nuk kanë bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal ashtu siç është përshkruar dhe arsyetuar në mënyrë të detajuar më lartë.

134. Në dritën e elaborimeve të mësipërme, Gjykata konstaton se në rastet e përmendura mosnjoftimet e parashtrueseve të kërkesës lidheshin me mosnjoftime që kryesisht konsistonin në shfrytëzimin e një mjeti juridik të përcaktuar në ligjet respektive (në rastin KI108/10 parashtruesi i kërkesës nuk ishte njoftuar lidhur me padinë e ish-punëdhënësit të tij kundër Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të parashtruar në Gjykatën Supreme; në rastin KI103/10 – parashtruesi i kërkesës nuk ishte njoftuar për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga ana e Prokurorit Publik dhe Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, ishte nxjerrë në praninë e Prokurorit publik, por pa e njoftuar dhe pa e thirrur parashtruesin e kërkesës që të merrte pjesë në procedurë në të njëjtën mënyrë siç e kishte thirrur Prokurorin publik; dhe në

rastin KI10/14 –Gjykata Supreme nuk e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për ekzistencën e procedurës lidhur me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, të parashtruar nga pala kundërshtare. Për më tepër, Gjykata Supreme kishte aprovuar kërkesën e palës kundërshtare për kthim në gjendje të mëparshme, si dhe përmes të njëjtit Aktgjykim revizionin e tij e kishte pranuar si të themeltë, duke anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, në dëm të parashtruesit të kërkesës; në rastin e GJEDNJ-së *Borgers kundër Belgjikës* – Gjatë zhvillimit të seancës shqyrtuese, të mbajtur në Gjykatën e Kasacionit, avokati i përgjithshëm kishte paraqitur propozimin e tij se kërkesa e parashtruesit, e parashtruar në këtë Gjykatë ishte e pabazuar. Për faktin që parashtruesi nuk kishte qenë i njoftuar paraprakisht përkitazi me propozimin e avokatit të përgjithshëm, ai gjatë kësaj seance shqyrtuese nuk kishte mundësi t'i përgjigjej propozimit të tij, si dhe më pas të ofronte vërejtjet e tij me shkrim në Gjykatë; dhe në rastin e GJEDNJ-së *Grozdanoski kundër ish-RJM* - Parashtruesi, si palë në procedurë nuk ishte njoftuar kurrë lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga prokurori publik, e cila kërkesë ishte aprovuar nga Gjykata Supreme, dhe e cila ishte e pafavorshme për parashtruesin).

135. Bazuar në atë si më sipër, rezulton se rrethanat faktike dhe juridike të rasteve të lartpërmendura përkojnë me rrethana të ndryshme nga ato në rastin e parashtruesit. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se sqarimi i dhënë nga Gjykata Supreme, përmes të cilit theksohet se dispozita ligjore në fuqi, përkatësisht paragrafi 2 i nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale *[...] përcaktohet obligimi i Gjykatës Supreme që vetëm kopjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, [...] ti përcillet palës kundërshtare [Prokurorit të Shtetit] e cila në afat prej 15 ditëve mund të paraqesë përgjigjeje në ankesë[...]*” dhe rrjedhimisht pas paraqitjes së përgjigjes të Prokurorit ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë *“[...] përfundon obligimi i gjykatës dhe konsiderohet se plotësohen kushtet procedurale për vendosje lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë”*.
136. Prandaj, Gjykata konstaton se zbatimi i paragrafit 2 të nenit 435 [Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga kolegji i Gjykatës Supreme] të Kodit të Procedurës Penale, si dhe sqarimi i dhënë në përgjigjen e 8 majit 2020 të Gjykatës Supreme, konsiston në respektimin e parimit të kontradiktoritetit të përcaktuar në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
137. Rrjedhimisht, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, prandaj kjo pjesë e kërkesës duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.
- (ii) *Në lidhje me pretendimin për shkelje të parimit të barazisë së armëve si rezultat i mospranimit të provave materiale të propozuara nga ai në procedurë pranë gjykatave të rregullta, respektivisht korrespondencën elektronike dhe Vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës*
138. Gjykata fillimisht vëren që nga shkresat e lëndës, nuk rezulton që parashtruesi i kërkesës pretendimin për mospranimin e provave nga gjykatat e rregullta, në mënyrë specifike ta ketë ngritur para gjykatave të rregullta.

139. Lidhur me çështjen e *mospranimit të provave nga gjykatat e rregullta*, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson që: **(i)** provat të cilat merren pa një vendim gjyqësor duhet të shpallen të papranueshme kur ato dorëzohen nga Prokuroria e Shtetit, jo atëherë kur ato dorëzohen nga pala në procedurë. Sipas tij, legjislacioni në fuqi nuk parasheh asnjë kufizim në lidhje me të drejtën e palës së akuzuar që të ofrojë prova dhe argumente përmes të cilave e dëshmon pafajësinë e tij. Rrjedhimisht, sipas tij është në kompetencën e gjyqësorit të rregullt që për çështje të vërtetësisë së komunikimit (provës së papranueshme) të urdhërojë ekspertizë dhe të vërtetojë origjinalitetin e atyre provave (komunikimit elektronik).
140. Në këtë kontekst dhe në bazë të pretendimeve të ngritura në kërkesën e tij nuk specifikohet se për cilën provë apo komunikim elektronik të refuzuar nga gjykata e rregullta është fjala. Në këtë rast, Gjykata duke iu referuar përmbajtjes së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore PKR.nr.432/15, te 18 dhjetorit 2017 në të cilin reflektohen edhe kundërshtimet e palëve gjatë seancës dëgjimore në lidhje me administrimin e provave nga gjykata, vëren se në lidhje me kërkesën e pranimit të një komunikimi elektronik (e-maili) në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Zëvendësdrejtorit të Kompanisë ISN, kjo kërkesë ishte bërë nga A.R (parashtrues në kërkesën KI230/19). Në lidhje me këtë, Gjykata Themelore kishte theksuar se *“[...] sipas Gjykatës nuk mund të qëndroj argumenti i Prokurorisë, e cila ka theksuar se pasi që i pandehuri A.R. dhe mbrojtësi i tij kanë propozuar leximin e provës, dhe këtë nuk e kundërshtojnë i pandehuri Hakif Veliu me mbrojtësin e tij, një prove e tillë nuk është kontestuese te lexohet. Gjykata nuk pajtohet me këtë konstatim për faktin se disponibiliteti i palëve nuk është parim i procedurës penale, por i disa procedurave tjera, dhe në procedurë penale mund të jetë përjashtim atëherë kur parashihet me ligj, ndërsa ne rastin konkret për nxjerrjen e një prove të tillë ligji ka paraparë procedura të qarta, për shkak edhe të ndjeshmërisë ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut të parapara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ngase nëse pranohen prova të tilla do të cenohej siguria juridike e qytetarëve të Kosovës, ose të atyre që kryejnë vepra në Kosovë”*.
141. Prandaj, bazuar në atë si më sipër, dhe nëse parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij i referohet kësaj prove atëherë Gjykata vëren se pretendimin në lidhje me komunikimin elektronik e kishte ngritur i pandehuri tjetër, përkatësisht parashtruesi në rastin KI230/19 e jo parashtruesi i kërkesës.
142. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës e vë theksin në pretendimin e tij se prova e paraqitur nga ana e tij, përkatësisht **(ii)** Vendimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës i 28 dhjetorit 2007 për përcaktimin e çmimit kushtues të shërbimeve të përkthimit, nuk është shqyrtuar fare nga Gjykata. Rëndësia e pranimit të kësaj prove, si dhe e-mailat e dorëzuar, sipas tij kanë rëndësi të jashtëzakonshme, sepse me pranimin e këtyre provave do të arrihej një rezultat tjetër nga ai që ka arritur gjyqësori i zakonshëm.
143. Parashtruesi i kërkesës në vijim konteston pranimin si provë nga ana e gjyqësorit, të **(iii)** *“një shkresë të cilën e konsideron si kontratë”* dhe mbi bazën e të cilës merret vendimi për dënimin e tij dhe se sipas tij, ai dokument nuk gjendet as në arkivin e Universitetit të Prishtinës dhe as në Ministrinë e

Financave dhe se e njëjta nuk është përdorur asnjëherë nga ana e tij për të ekzekutuar ndonjë pagesë.

144. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se këto pretendime nuk ishin ngritur në ankesën e tij në Gjykatën e Apelit e as në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë dhe plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar më 9 korrik 2019 dhe 29 korrik 2019, respektivisht në Gjykatën Supreme.
145. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimet e lartcekura, në mënyrë specifike i ngrit për herë të parë në kërkesën e tij para kësaj Gjykate.
146. Në një kontekst të tillë, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial.
147. Gjykata fillimisht thekson se, përderisa në kontekstin e makinerisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rregulli për shterimin e mjeteve juridike duhet të aplikohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa ndonjë formalizëm të tepruar, ky rregull zakonisht kërkon që ankesat e pretendimet që synohen të ngrihen më vonë në proces gjyqësor, duhet të jenë ngritur edhe para gjykatave të rregullta, të paktën në substancë dhe në respektim të kushteve formale dhe afateve të përcaktuara përmes ligjit të aplikueshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 korrikut 2015, paragrafi 89 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës, KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2009, paragrafi 71; KI 154 /17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 92; dhe KI155/18, parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50).
148. Edhe më specifikisht, GJEDNJ mban qëndrimin se, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 93; dhe rastin KI155/18, cituar më lart, paragrafi 49).
149. Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "substancë" para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë

mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dyja kuptimet (shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, KI71/18, parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafin 73; dhe rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 94).

150. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës, rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë gjykatave të rregullta, përfshirë Gjykatën e Apelit, të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; dhe rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 95).
151. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit përkitazi me pretendimin e tij për shkelje të barazisë së armëve si rezultat i mospranimit të provave nga gjykatat e rregullta është e papranueshme për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor

152. Gjykata duke ju referuar praktikës së vet gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, rithekson se, edhe pse autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ, gjykatat e tyre duhet “të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre” (shih *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr.12945/87 Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 45, shih rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri i 17 majit 2018, paragrafi 54).
153. Rrjedhimisht, Gjykata përsërit se e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu edhe në atë material (shih *mutatis mutandis* rastin e lartcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, paragrafi 54).
154. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se: “*asnjë pretendim nuk është trajtuar nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme*” si dhe fakti që ja ka bashkëngjitur të gjitha shkresat e dorëzuara, janë arsye të mjaftueshme që Gjykata të shqyrtojë nëse pretendimet e përmendura janë

trajtuar ose jo. Përsëritja e këtyre pretendimeve dhe në këtë kërkesë kushtetuese, do të konsiderohej përsëritje e pretendimeve të ngritura para gjykatave të zakonshme, dhe do të rezultonte me pretendime për një instancë të katër. Prandaj parashtruesi nuk dëshiron të rrëshqet në atë sferë, sepse konsideron se pretendimet e tij duhet të mbesin në nivel kushtetues – dhe se është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë argumentet kushtetuese të ngritura nga ai në lidhje me mos-arsyetim të pretendimeve të tij”.

155. Në dritën e këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Apelit e kishte refuzuar ankesën e tij të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe më pas Gjykata Supreme e kishte refuzuar edhe kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar kundër Aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit gjatë vendimmarrjes kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.
156. Në përfundimin e lartcekur, Gjykata Supreme ka arritur pasi që ka shqyrtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore, kur parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për veprën e kryer penale, ankesën e tij të parashtruar në Gjykatë të Apelit dhe kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar në Gjykatën Supreme.
157. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në refuzimin e një ankese, apo siç është rasti konkret, refuzimi i një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët, në këtë rast Gjykatës së Apelit (shih rastet e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, paragrafët 59-60).
158. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj, në lidhje me pretendimin për shkelje të dispozitave të procedurës penale kishte konstatuar se Gjykata Themelore kishte dhënë arsyetim ligjor përkitazi me të gjitha pretendimet e ngritura në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Ndërsa në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të ligjit penal nga ana e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, Gjykata Supreme kishte konstatuar se “[...]Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj drejtë ka konstatuar se në veprimet e [parashtruesit të kërkesës] janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par. 1 dhe nenit 23 të KPK-së, pasi që [parashtruesi i kërkesës] kishte cilësinë e personit zyrtar siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 107 par.1 nënpar.1.1 të KPK-se, meqë ishte i zgjedhur për të përfaqësuar UP përkatësisht zyrën e prokurimit dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të palës tjetër ka bërë prezantimin e rremë të raportit përkatësisht ka vënë në lajthim personin për të bërë pagesë të kundërligjshme pasi që paraprakisht ishte ndryshuar neni 17 i kontratës prej njësisë "1000 fjalë 12.65 €" në "1000 karaktere 12.65 €" dhe si pasoje e këtij ndryshimi do të realizoheshin pagesa më të larta të përkthimit të teksteve universitare.”

159. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. Nr. 432/15] të 18 dhjetorit 2017, përmes të cilit kishte theksuar se: *“Gjykata nuk e akcepton teorinë e mbrojtjes së të pandehurit Hakif Veliu të paraqitur nga vetë ai, por edhe nga mbrojtësi i tij av. Skender Musa, për faktin se Hakif Veliu duke vepruar si Shef i Zyrës së Prokurimit të UP-së, ka qene personi përgjegjës për nënshkrimin e kontratave, dhe njohës i procedurave te prokurimit publik. Për Gjykatën është e pa logjikshme se pas nënshkrimit të Kontratës sipas njësisë matëse "Fjala" e cila ishte edhe kusht ne dosjen e tenderit, i pandehuri ne cilësinë e sipër cekur, ka nënshkruar një Kontrate te dyte, pa i ndryshuar as datën e as numrin, por vetëm njësinë matëse. Është fakt gati notor qe ndryshimi i njëjesisë matëse ka implikime edhe ne buxhet, e duke u bazuar ne detyrat e punës së tij, për Gjykatën është e pabesueshme se i njëjti këtë e ka bërë nga padituria. Deklarimet e Hakif Velit në procedurë paraprake dhe në shqyrtim gjyqësor nuk kanë qenë në harmoni njëra me tjetrën. Deri sa ne procedure paraprake është mbrojtur se nënshkrimi ne Kontratën sipas njësisë matëse "karakterit", nuk është i tij, por kjo është falsifikuar, pas Ekspertizës Grafologjike të Agjencionit Kosovar të Forenzikes, Sektori per Ekspertimin e dokumenteve dhe dorëshkrimeve 2015-22.1112015-1983 edt. 08.07.2015, ka deklaruar se te njëjtën e ka nënshkruar, por e ka nënshkruar si lloj reference për ISN. Gjykata është e vetëdijshme që i pandehuri ka te drejte te mbrohet ne mënyrën që atë e favorizon, mirëpo kjo mospërputhje ne deklarim, nënshkrimi i Kontratës sipas njësisë matëse "Karakterit" dhe pastaj te gjitha veprimet e tij lidhur me përgatitjen e dokumenteve për Komisionin, shpërfaqin atë qe quhet Mens Rea (mendja kriminale) për të kryer vepër penale ne bashkëkryerje me te pandehurit e tjerë, në mënyrën siç u elaborua më lartë.”*
160. Përderisa, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj [PAKR. Nr. 528/2018, të 16 prillit 2019] së pari kishte konstatuar se pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk janë ta bazuara, duke vlerësuar se aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Gjykata e Apelit, në mënyrë specifike duke iu referuar pretendimit të parashtruesit të kërkesës se aktgjykimi i kundërshtuar mbështetet në prova të papranueshme, vlerësoi se *“[...] provat e administruara në shqyrtim gjyqësor në këtë çështje janë marrë konform dispozitave ligjore, ndërsa, këto prova janë thellësisht të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimit të dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga Gjykata.”* Së dyti, Gjykata e Apelit përkitazi me pretendimet e parashtruesit për shkelje të ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike kishte vërtetuar se: *“[...] duke pasur parasysh provat e administruara por edhe mbrojtjet e të akuzuarve të cilat në mënyre të detajuar janë theksuar në këtë aktgjykim sipas vlerësimit të kësaj Gjykate rezulton nëpërmjet ndryshimit të kontratës bazë kanë vënë në lajthim personat e autorizuar për kryerjen e pagesës së kundërligjshme. [...] Prandaj kjo Gjykatë i konsideron krejtësisht jo logjike dhe të pabazuara pretendimet se ndryshimi i kontratës është bërë vetëm si referencë për ISN dhe nuk kanë prodhuara efekt juridik, aq më tepër kur kihet parasysh fakti se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se bazuar në kushtet e tenderit palët kontraktuese e kanë pasur të ndaluar ta bëjnë një gjë të tillë sepse në mënyrë decrive ishte parashikuara (neni IV pika 3 e dosjes së tenderit) se çmimet në kontratë ishin të fiksuara dhe nuk mund të ndryshoheshin.”* Në fund, Gjykata e Apelit kishte konstatuar se *“me veprimet e*

lartpërmendura, parashtruesi i kërkesës i ka konsumuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, dhe si rrjedhojë gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyre të plotë dhe se drejtë janë aplikuar edhe dispozitat e ligjit penal”.

161. Në këtë kontekst, Gjykata po ashtu rikujton se rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore – me të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme nuk kishte shkelje esenciale të procedurës penale dhe ligjit penal (shih rastin e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106).
162. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në secilën pikë të mundshme të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, ajo i ka adresuar argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës për sa i përket zbatimit të të drejtës materiale dhe procedurale (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Holandës*, paragrafi 61; *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25, shih rastin e cituar më lartë KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, paragrafi 107). Duke vepruar kështu, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
163. Në fund, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht kërkesa e tij në lidhje me këtë pretendim është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
164. Gjykata rikujton gjithashtu se parashtruesi i kërkesës duke iu referuar rastit të Gjykatës KI31/17 (parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktgjykim, i 30 majit 2017), thekson se edhe në rastin e tij, si të parashtruesit në rastin KI31/17, përmes një vendimi të falsifikuar i është mohuar e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke rezultuar me një gjykim arbitrar ndaj tij.
165. Në rastin përkatës KI31/17, Gjykata kishte gjetur shkelje në nivel të Gjykatës Themelore, duke e shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin [C. nr. 162/09] e 29 tetorit 2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe për pasojë, i kishte shpallur të pavlefshme të gjitha vendimet e tjera të autoriteteve publike që kanë rezultuar si rrjedhojë e ankesave përkatëse. Për më tepër, Gjykata konsideroi se dështimi

i gjykatave në të gjitha instancat e procedurave për t'i marrë në konsideratë dëshmitë dhe dëshmitaret e propozuar nga parashtruesi i kërkesës, është në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si elemente thelbësore të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, paragrafin 107 dhe dispozitivin e Aktgjykimit në rastin KI31/17, cituar më lart).

166. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, dhe rrjedhimisht është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

III. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe “mbrojtjes së veçantë”

167. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës konsideron se *“gjatë tërë procedurës penale është vendosur në një pozicion i cili ka cenuar në vazhdimësi parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi që rasti kishte ndjeshmëri të lartë, si rezultat i personave tjerë të përfshirë në këtë rast dhe presionit të publikut dhe mediave, duke rezultuar me ndikim në rastin e tij.”* Ai pretendon se presioni ndaj gjykatave të rregullta ishte shtuar me rastin e inicimit të kallëzimeve penale ndaj kryeprokurorit të shtetit dhe prokurores D.H., nga palët e tjera të përfshira në procedurë.
168. Në vazhdim, parashtruesi i kërkesës në kontekst të pretendimit përkitazi me *“mbrojtjen e veçantë”* thekson se nuk janë shqyrtuar pretendimet e tij të dorëzuara përmes avokatëve të tij dhe mos mbajtja e procesverbalit të seancës nga Gjykata e Apelit, e ka privuar atë nga *“mbrojtja e veçantë”* e cila duhet të ju ofrohet sinjalizuesve. Më tej ai pretendon që gjykatat e rregullta nuk e kanë trajtuar as faktin që ishte pikërisht ai i cili e njoftoi menaxhmentin e Universitetit të Prishtinës mbi *“parregullsitë e kontratës”*.
169. Megjithatë, nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës këto pretendime specifike për herë të parë i ngritë në kërkesën e tij para kësaj Gjykate, përkatësisht këto pretendime nuk ishin ngritur as në ankesën e tij, dhe plotësimin e ankesës në Gjykatën e Apelit, dhe as në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë dhe plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë [9 korrik 2019 dhe 29 korrik 2019] në Gjykatën Supreme.
170. Në këtë kontekst, Gjykata vëren, se parashtruesi i kërkesës në plotësimin e ankesës së tij, të 24 dhjetorit 2018, të parashtruar në Gjykatën e Apelit, përkitazi me dënimin, kishte kërkuar aplikimin e rrethanave lehtësuese në rastin e tij, për arsye se mes tjerash, *“gjatë gjitha fazave të kësaj procedure penale ka treguar gatishmëri në bashkëpunim me organet e drejtësisë, duke u përgjigjur në pyetjet të prokurorisë në mënyrën më të sigurtë dhe brenda njohurive që ka poseduar, njëkohësisht, ka treguar bashkëpunim dhe korrektësi me gjykatën, kjo rrethanë nga gjykata e shkallës së parë nuk është vlerësuar drejtë gjatë caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit”*.
171. Të njëjtin arsyetim, parashtruesi i kërkesës e kishte dhënë edhe në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar në Gjykatën Supreme më 9 korrik

2019, përmes të cilës kishte pretenduar se Gjykata e Apelit, në Aktgjykimin [PAKR. Nr. 528/2018] e 16 prillit 2019 gjatë matjes së dënimit nuk ka marrë parasysh faktin që, sipas tij, *”si pasojë e paraqitjes së rastit [nga parashtruesi i kërkesës] pranë rektoratit të UP-së, kjo çështje penale është zbuluar dhe është gjykuar, dhe është parandaluar dëmi më i madh në lartësi prej 320.000.00, në buxhetin e UP-së, kjo rrethanë është jashtëzakonisht lehtësuese [...]”*.

172. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike thekson se është privuar nga “mbrojtja” të cilën e ka kërkuar përmes parashtresave të dorëzuara nga avokatët e tij dhe të cilat pretendon se i ka ngritur në seancën e 16 prillit 2019, të zhvilluar në Gjykatën e Apelit. Prandaj mos mbajtja e procesverbalit nga Gjykata e Apelit ia ka pamundësuar atij që t’i dëshmojë Gjykatës *“se në të njëjtën seancë janë ngritur fjalë për fjalë, këto pretendime, sikurse në këtë kërkesë.”* Sipas tij, në formulime të ngjashme, por pa referencë në praktikën e GJEDNJ-së, gjenden në shkresat e dorëzuara përmes avokatëve të tij.
173. Përkitazi me pretendimin e mos mbajtjes së procesverbalit, i cili pretendim në mënyrë specifike ishte ngritur nga A.R. [parashtrues në rastin KI230/19] Gjykata Supreme kishte konstatuar se: *“Pretendimi se në gjykatën e shkallës së dytë nuk është mbajtur procesverbal me shkrim po ashtu del të jetë i pabazuar, meqë një procesverbal i tillë gjendet edhe në shkresat e lëndës”*.
174. Për më tepër, Gjykata në këtë rast i referohet procesverbalit të mbajtur në seancën e Gjykatës së Apelit më 16 prill 2019, të cilin kjo Gjykatë e ka siguruar përmes dosjes së plotë të lëndës, të dërguar nga Gjykata Themelore.

“Seanca filloi në 10:00h

Kryetari i kolegjit Afrim Shala e hapi seancën e kolegjit dhe i njoftoj të pranishmit me përberjën e kolegjit: Afrim Shala - kryetar

Mejreme Memaj- raportuese

Hava Haliti - anetarë

Procesverbalin e mban bashkëpunëtorja profesionale [S.G.]

Nuk ka vërejtje në përbërjen e kolegjit.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPP në të cilën morën pjesë i akuzuari Hakif Veliu dhe mbrojtësi i tij avokati Durim Osmani i angazhuar në këtë fazë ankimore, dhe mbrojtësi i të akuzuarit A.R. avokati Artan Qerkini po ashtu i angazhuar në këtë fazë ankimore. Prokurori i Apelit edhe pse i njoftuar me rregull nuk mori pjesë në seancë. Për të akuzuarin A.R. nuk është kthyer fletkthesa mirëpo sipas mbrojtësit të tij ai e ka marrë njoftimin por për shkaqe shëndetësore nuk ka mund të merr pjesë në seancë, kurse pajtohet që seanca të mbahet pa praninë e tij. Gjyqtarja raportuese [M.M] e paraqiti çështjen penale. Palët pa pyetje pa vërejtje. Prokurori i Apelit me parashtresën e tij me shkrim PPA/I.m.34/2018 datë 23.01.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurores të aprovohet, kurse ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve Hakif Veliu e A.R. të refuzohen si të pabazuara. Mbrojtësi i të akuzuarit Hakif Veliu avokati Durim Osmani pasi që sqaroi disa nga pretendimet nga ankesa dhe plotësimi i ankesës mbështeti propozimin e bërë në të, kurse i akuzuari mbështeti mbrojtësin dhe ankesën e tij të bërë

me shkrim. Po ashtu edhe mbrojtësi i të akuzuarit A.R. pasi që sqaroi disa nga pretendimet nga ankesa e mbështeti propozimin e bërë në të.

Seanca përfundoj në 11.00”

175. Rrjedhimisht, Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës këto pretendime specifike nuk i kishte ngritur në parashtesat e tij para gjykatave të rregullta.
176. Prandaj, duke ju referuar kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial të elaboruar në paragrafët 139 deri në 143 të këtij Aktvendimi, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
177. Prandaj, dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse:
 - I. Pretendimi përkitazi me (i) shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve në procedurë si rezultat i mosnjohimit të tij për shkresën e Prokurorit të Shtetit është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 e 48 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës; ndërsa pretendimi për (ii) shkelje të parimit të barazisë së armëve për shkak të mospranimit të provave nga gjykatat e rregullta është i papranueshëm si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit, dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës;
 - II. Pretendimi për shkelje të parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 e 48 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës; dhe
 - III. Pretendimi për cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe “mbrojtjes së veçantë” është i papranueshëm si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit, dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

178. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht “pezullimin e vendimeve gjyqësore”.
179. Në kërkesën e tij për vendosjen e masës së përkohshme, parashtruesi i kërkesës konsideron se i ka ofruar Gjykatës, jo vetëm një arsyetim *prima facie* rreth meritave të rastit, por ka shpërfaqur qartazi arbitraritetin e autoriteteve gjyqësore dhe shkeljen e lirive dhe të drejtave të tij themelore.

180. Duke pasur parasysh se Gjykata tani ka vendosur lidhur me papranueshmërinë e kërkesës, nuk e konsideron të nevojshme që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për miratimin e masës së përkohshme.
181. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit dhe pikën (a) të paragrafit 4 të rregullit 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa të deklarohet e papranueshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI107/19, me parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 90; KI159/18, me parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 majit 2019, paragrafët 89-91; KI19/19 dhe KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi dhe Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55).


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (b), 39 (2), 57 dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJE këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi